



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AVOKATI I POPULLIT**  
**Seksioni i Veçantë**



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

**Nr. Prot.**  
**Nr. Dok. 201700383/10**

**Tiranë** \_\_\_/\_\_\_/2017

**Lënda :** *Rekomandim për analizimin e rastit të shtetasit të paraburgosur M.K. të dhunuar fizikisht nga punonjësit e Komisarariatit të Policisë Krujë.*

**Drejtuar :** **Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve**  
**Z. Arben ÇUKO**

**Tiranë**

**Drejtorit të IEVP**  
**Z. Ajet IBRO**

**Fushë Krujë**

***Të nderuar zotërinj,***

Në institucionin e Avokatit të Popullit ka bërë ankesë shtetasi A.K. me banim në lagjen "Seseve", Rruga e Spitalit, Krujë. Ankuesi shkruan se, në datën 25.03.2017, rreth orës 03:00, punonjësit e Komisarariatit të Policisë Krujë kanë arrestuar vëllanë e tij, të quajtur M.K., për kryerjen e veprës penale të "Vjedhjes me dhunë". Në datën 28.03.2017 ankuesi ka takuar vëllanë e tij në IEVP Fushë Krujë ku mbahet i arrestuar. M. i ka thënë ankuesit se gjatë marrjes në pyetje punonjësit e Komisarariatit të Policisë Krujë e kanë keqtrajtuar atë duke ushtruar dhunë fizike dhe psikologjike të vazhdueshme. Sipas ankuesit, për shkak të dhunës fizike vëllai i tij kishte shënja të dukshme në trup. Gjithashtu ankuesi pretendon se nga personeli shëndetësor i IEVP Fushë Krujë nuk i është dhënë asnjë ndihmë dhe shërbim mjekësor vëllait të tij.

Për të bërë të mundur shqyrtimin e kësaj ankese, bazuar në pikën 4, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku parashikohet se: "*Organet dhe funksionarët publike janë të detyruar t'i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij*"; në ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar dhe konkretisht, në nenin 19, gërma "b" ku parashikohet se: "*Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin*"; si dhe në nenin 19, paragrafi i fundit, ku parashikohet se: "*Avokati i Popullit ka të drejtë të caktojë një afat për kryerjen e veprimeve të mësipërme*", me shkresat nr. K2/A21-3 Prot.,

datë 06.04.2017; nr. K2/A21-6 Prot., datë 09.05.2017; nr. K2/A21-7 Prot., datë 06.06.2017 dhe nr. K2/A21-8 Prot., datë 13.07.2017, i kemi kërkuar drejtuesve të I EVP Fushë Krujë që të verifikonin këtë rast dhe të na dërgonin shpjegime brenda afateve ligjore të caktuara nga ana jonë lidhur me:

1. A janë konstatuar nga punonjësit e I EVP Fushë Krujë shënja dhune tek i paraburgosuri M.K. në momentin e sjelljes së tij në institucionin tuaj nga Komisariati i Policisë Krujë?
2. Nëse po, a janë pasqyruar ato në regjistrin përkatës të marrjes së tij në dorëzim?
3. A ka patur pretendime për dhunim fizik dhe psikologjik i paraburgosuri M.K. kur ka dalë para komisionit të pritjes në institucionin tuaj?
4. Nëse po, a janë pasqyruar ato në procesverbalin e mbajtur nga komisioni?
5. A janë konstatuar nga komisioni i pritjes shënja dhune në trupin e të paraburgosurit M.K.?
6. Nëse po, a janë pasqyruar ato në procesverbalin përkatës të mbajtur nga ky komision dhe çfarë veprimesh janë kryer nga ana juaj lidhur me pretendimet e paraqitura prej tij.
7. A janë të vërteta pretendimet e ankuesit se nga personeli shëndetësor i institucionit tuaj nuk i është ofruar ndihmë mjekësore të paraburgosurit M.K.?

Pas kërkesës tonë të katërt, Drejtori i I EVP Fushë Krujë me shkresën nr. 4036 Prot., datë 28.07.2017, ndërmjet të tjerave na informoi se:

“Shtetasi M.K. është pranuar në këtë institucion në datën 27.03.2017 dhe në datën 28.03.2017 është mbledhur komisioni i pritjes i cili ka marrë kontakt me të paraburgosurin.

*Referuar librit të komisionit të pritjes rezulton se nga ndihmësmjeku i shërbimit janë bërë shënime ku është konstatuar se i dënuari ka shënja dhune dhe ka referuar se është goditur nga punonjësit e Policisë së Shtetit gjatë kohës së qëndrimit në Komisaratin e Policisë Krujë.*

*Pra, pretendimet e të paraburgosurit janë shënuar në procesverbalin e mbajtur nga komisioni i pritjes”.*

Në lidhje me pretendimet e ankuesit se nga personeli mjekësor i institucionit nuk i është ofruar ndihmë mjekësore, në këtë shkresë informohemi se, shërbimi mjekësor i është ofruar të paraburgosurit por vetëm nga personeli ndihmësmjek, pasi në periudhën që ai është pranuar në institucion nuk kishte mjek të punësuar.

E shikojmë të nevojshme që të sjellim në vëmendje se, në nenin 30 të Ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe e të paraburgosurve”, të ndryshuar, (Pranimi në institucion) parashikohet se:

*“Në çdo institucion krijohet komisioni i pritjes për të pranuar të sapoardhurit. Komisioni informon të paraburgosurin dhe të dënuarin në një gjuhë të kuptueshme për rregulloren e institucionit, të drejtat dhe detyrimet e tij, të drejtat e tij për këshillim e ndihmë ligjore, rregullat e procedurat për paraqitjen e kërkesave e të ankesave.*

*Autoritetet e institucionit i pajisin menjëherë të paraburgosurit dhe të dënuarit me informacion të shkruar për rregullat në institucion, të drejtat dhe detyrimet e tyre. Të paraburgosurit dhe të dënuarit që i përkasin minoriteteve etnike ose gjuhësore, të huaj ose persona pa shtetësi, pajisen me informacion me gojë dhe me shkrim, në gjuhën që e kuptojnë, për të drejtat dhe detyrimet e tyre në institucion. I dënuari ka të drejtë të mbajë informacionin me shkrim për vete.*

*Menjëherë pas pranimit, drejtuesit e institucionit i mundësojnë të paraburgosurit dhe të dënuarit të huaj njoftimin e familjes, këshilltarit ligjor, përfaqësuesit konsullor ose organizatës kompetente që vepron në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.*

*Shtetasve të huaj, që nuk kanë përfaqësi diplomatike ose konsullore në vend, refugjatëve ose personave pa shtetësi u mundësohet komunikimi me përfaqësitë diplomatike të shtetit që mbron interesat e tyre ose me autoritetin kombëtar ose ndërkombëtar, detyra e të cilit është mbrojtja e interesave të këtyre personave.*

*Pas momentit të pranimit në institucion, të sapoardhurit menjëherë duhet t'i nënshtrohen një vizite ekzaminuese dhe interviste mjekësore nga ana e mjekut të institucionit për njohjen dhe parandalimin e përhapjes së sëmundjeve ngjitëse në institucion, vetëvrasjeve, regjistrimin e plagëve dhe dëmtimeve në kohën e duhur.*

*Shenjat e dëmtimeve fizike, të identifikuar në vizitën e pranimit, duhet të regjistrohen në një regjistër të veçantë së bashku me shpjegimet e të sapoardhurit rreth rrethanave të shkaktuara.*

*Mjeku, në rast se i kërkohet, duhet të pajisë të sapoardhurin me një certifikatë mjekësore, e cila shpjegon gjendjen e lëndimeve dhe rrethanat e tjera.....”*

Ndërsa në nenin 13 të VKM nr. 437 datë 20.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve” (Veprimet paraprake gjatë pranimit) parashikohet se:

*“1. Pas momentit të pranimit në institucion, të sapoardhurit menjëherë i nënshtrohen një vizite ekzaminuese dhe interviste mjekësore nga ana e mjekut të institucionit për njohjen dhe parandalimin e përhapjes së sëmundjeve ngjitëse në institucion, vetëvrasjeve, regjistrimin e plagëve dhe dëmtimeve në kohën e duhur, duke respektuar parimin e konfidencialitetit.*

*2. Shenjat e dëmtimeve fizike, të identifikuar në vizitën e pranimit, duhet të regjistrohen në një regjistër të veçantë së bashku me shpjegimet e të sapoardhurit mbi rrethanat e shkaktuara dhe njoftohet menjëherë drejtuesi i I EVP-së dhe prokurori....”.*

Nga shqyrtimi paraprak i kësaj ankese dhe i përgjigjes së dërguar nga I EVP Fushë Krujë, të cituar më sipër, rezulton se pretendimet e ankuesit se, vëllai i tij, shtetasi M.K., është dhunuar fizikisht nga punonjësit e Komisarariatit të Policisë Krujë janë të vërteta.

Ndërkohë nga përgjigjia e dërguar me shumë vonesë nga I EVP Fushë Krujë konstatohet se, nga punonjësi i personelit shëndetësor, ndihmësmjeku, nuk është zbatuar me korrektesë detyrimi i parashikuar në pikën 2 të nenit 13 të VKM nr. 437, datë 20.05.2015. Ndonëse ndihmësmjeku ka konstatuar shenjat e dhunës fizike tek i paraburgosuri M.K. dhe ndërkohë ka bërë shënimet përkatëse në librin e komisionit të pritjes, nuk rezulton që prej tij të jetë njoftuar Drejtori i I EVP Fushë Krujë, si dhe organi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Krujë prej këtij të fundit.

Është rasti të theksojmë se, qëllimi i miratimit të Ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe e të paraburgosurve”, të ndryshuar dhe i VKM nr. 437, datë 20.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve” është rregullimi i marrëdhënieve juridike dhe sigurimi i veprimtarisë normale të aparatit shtetëror, (I EVP-ve), si dhe mbrojtja e të drejtave dhe interesave të ligjshme të shtetasve të paraburgosur dhe të dënuar me burgim. Mirëpo në rastin konkret janë cënuar rëndë këto marrëdhënie juridike, sepse duke moskryer detyrat konform dispozitave ligjore të cituara më sipër është cënuar veprimtaria normale e I EVP Fushë Krujë, si dhe është dëmtuar rëndë imazhi i këtij institucioni. Në të njëjtën kohë nga ky mosveprim janë dëmtuar rëndë edhe interesat e ligjshme të shtetasit M.K., të cilit i është cënuar integriteti fizik për shkak të dhunës fizike të ushtruar ndaj tij nga punonjësit e Komisarariatit të Policisë Fushë Krujë.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike” dhe të nenit 21/c, të Ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, në të cilin thuhet se: “Pas përfundimit të hetimeve, Avokati i Popullit..., paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi epror i organit që ka shkaktuar shkeljen”.

### **REKOMANDOJMË:**

1. Analizimin e këtij rasti, nxjerrjen e përgjegjësive konkrete dhe marrjen e masave disiplinore ndaj personave përgjegjës që nuk kanë kryer detyrimet ligjore për njoftimin e drejtuesit të IEVP Fushë Krujë dhe organit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Krujë.

2. Marrjen e masave të nevojshme nga IEVP Fushë Krujë për njoftimin sa më shpejtë të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Krujë lidhur me keqtrajtimin fizik të shtetasit të paraburgosur M.K. nga punonjësit e Komisarariatit të Policisë Krujë.

3. Përgjithësimin e këtij rasti nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në të gjitha IEVP në vend me qëllim mospërsëritjen e tij në të ardhmen, si lidhur me vonesën e pajustificuar të kthimit të përgjigjes institucionit të Avokatit të Popullit, ashtu edhe për moszbatimin me korrektesë të nenin 13, pika 2, të VKM nr. 437 datë 20.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”.

Për masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, lutemi të na vini në dijeni brenda afatit ligjor prej 30 ditësh, i parashikuar në nenin 22 të Ligjit “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar.

Bashkëlidhur po ju dërgojmë dokumentet e mëposhtme:

1. Fotokopje e kërkesës për shpjegime nr. K2/A21-3 Prot., datë 06.04.2017;
2. Fotokopje e kërkesës për shpjegime nr. K2/A21-6 Prot., datë 09.05.2017;
3. Fotokopje e kërkesës për shpjegime nr. K2/A21-7 Prot., datë 06.06.2017;
4. Fotokopje e kërkesës për shpjegime nr. K2/A21-8 Prot., datë 13.07.2017.
5. Fotokopje e përgjigjes së Drejtorit të IEVP Fushë Krujë nr. 4036 Prot., datë 28.07.2017.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**KOMISIONERI**

**Arben SHKËMBI**